



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 624/prot.
18

Tiranë, më 22.12.2022

VENDIM

Nr. 936 Datë 22.12.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË STELLANTIS N.V. DHE HON HAI PRECISION INDUSTRY CO., LTD.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Stellantis N.V. dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Stellantis N.V. dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Stellantis N.V. dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd.

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët”, palët në transaksion janë:

Pala 1: Stellantis N.V. (Stellantis) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me objekt aktiviteti: Aktivitetet financiare, etj.

Stellantis është shoqëria mëmë e Grupit të Shoqërive Stellantis, një grup ndërkombëtar i angazhuar në projektimin, inxhinierinë, prodhimin, shpërndarjen, dhe shitjen e automjeteve automobilistike, komponentëve dhe sistemeve të prodhimit në të gjithë botën. Njëkohësisht siguron financim me pakicë për të mbështetur shitjen e automjeteve të markës së tij.

Stellantis N.V. është një shoqëri e krijuar nga bashkimi ndërmjet shoqërive Peugeot S.A. dhe Fiat Chrysler Automobiles N.V.

Stellantis N.V. nuk ka filiale, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri. Xhiroja e realizuar në tregun shqiptar është gjeneruar nëpërmjet një distributori të pavarur, palë e tretë, në tregun e shitjes së automjeteve¹.

Pala 2: Hon Hai Precision Industry Co., Ltd. (Foxconn) është një shoqëri aksionare, listuar në Bursën e Korporatave në Taivan, si një prodhues shumëkombësh tajvanëz i kontratave elektronike.

Foxconn është shoqëria mëmë e Foxconn Group, një prodhues ndërkombëtar i pajisjeve elektronike dhe ofrues i zgjidhjeve teknologjike. Grupi është aktiv në zhvillimin e automjeteve elektrike, shëndetit dixhital dhe robotikës dhe në teknologji të tilla si ai gjysmëpërçues dhe komunikimeve të gjeneratës së re.

Foxconn Group nuk ka degë/filiale të regjistruara në Shqipëri. Xhiroja e gjeneruar në tregun shqiptar, gjenerohet nëpërmjet filialit indirekt të Hon Hai, Belkin International, Inc, për shitjen e aksesoreve të celularëve dhe pajisjeve kompjuterike.

Shoqëria e përbashkët (JV) do të jetë me seli ligjore Hollandë, e cila do të vendoset në mirëkuptim nga Stellantis dhe Foxconn, dhe do të kryejë veprimtari të pavarur si një entitet ekonomik autonom. Stellantis dhe Foxconn synojnë të themelojnë një Joint Venture me funksione të plota, e cila do të jetë kryesisht aktive në projektimin dhe furnizimin e gjysmëpërçuesve për industrinë e automjeteve.

II. Përqendrimi

Më datë 23 shtator 2022, është nënshkruar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët”, ndërmjet shoqërive Stellantis N.V., dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd.

Stellantis, si një shoqëri globale lider e prodhimit të makinave të integruara plotësisht, dhe Foxconn, si një prodhues kryesor global i pjesëve dhe pajisjeve elektronike, synojnë të krijojnë një shoqëri me sipërmarrje të përbashkët, me seli në Amsterdam. Objektivat e biznesit dhe fusha e aktiviteteve të përcaktuara në marrëveshje, do të jenë:

-Krijimi i një aktori konkurrues për projektimin dhe furnizimin e gjysmëpërçuesve në tregun botëror të automjeteve; -ngritja e kapaciteteve organizative, të drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe aftësisë për të planifikuar, ndërtuar dhe shfrytëzuar zgjidhjet automobilistike në paragrafin e mësipërm; -synimi i adoptimit dhe instalimit të produkteve të shoqërisë tek Stellantis dhe Foxconn deri në vitin 2026; -shitja e zgjidhjeve të furnizuesit automobilistik tek të tretë, si dhe tek OEM

¹ VKK nr. 690, datë 28.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V”

(Original Equipment Manufacturer) dhe -sigurimi i furnizimit të Stellantis me gjysmëpërçues nga zona gjeografikisht të ndryshme (Azia, Amerika e Veriut, Evropa, etj).

Për qëllime të transaksionit të propozuar, fillimisht Foxconn do të inkorporojë një njësi ekonomike në Hollandë përpara mbylljes, në të cilën do të zotërojnë 100% të aksioneve. Pas implementimit të transaksionit, Stellantis do të blejë 50% të aksioneve të ndërmarrjes së përbashkët (JV), ndërsa 50% i mbetur do zotërohet nga Hon Hai Precision Industry Co., Ltd (Foxconn).

Pas mbylljes, kapitali aksionar total i kontribuar nga të dyja palët drejtpërdrejt ose tërthorazi në Shoqëri dhe në Ndërmarrjen e Re do të jetë 150,000,000 USD dhe aksionet e JV (shoqërisë) do të zotërohen 50% nga Stellantis dhe 50% nga Foxconn.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar, transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i projektimit dhe furnizimit me gjysmëpërçues për industrinë e automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i shoqërisë të përbashkët me funksione të plota J-V nga shoqëria Stellantis N.V. dhe shoqëria Hon Hai Precision Industry Co., Ltd., e cila do të operojë në tregun e projektimit dhe furnizimit me gjysmëpërçues për industrinë e automjeteve.

Stellantis N.V. dhe Foxconn Group nuk kanë asnjë entitet, filial, degë apo zyrë përfaqësimi të themeluar në Shqipëri. Stellantis N.V. ka realizuar të ardhura në Shqipëri nëpërmjet një distributori të pavarur, në tregun e shitjes së automjeteve dhe Foxconn Group ka realizuar të ardhura në tregun e shitjes së aksesorëve të celularëve dhe pajisjeve kompjuterike.

Ndërmarrja e përbashkët (J-V) nuk ka plane konkrete për të ushtruar aktivitet, në të ardhmen e afërt, në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",


VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Stellantis N.V. dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd.


2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA
()
Zv/Kryetar

Rezana KONOMI
()
Anëtar

Adriana BERBERI
()
Anëtar

Durim KRAJA
()
Anëtar

